

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1446/5 prot.

Tiranë, më 02.05.2023

VENDIM

Nr. 33, datë 02.05.2023

PËR

**“MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, QË PËRFITOJNË BURSË SIPAS KRITERIT EKONOMIK PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023, SHITESË NË FAZËN I, TË CILËT STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAM STUDIMI TË INTEGRUAR, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, pasi mori në shqyrtim Relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 1453/1, datë 02.05.2023 “Mbi miratimin e listave të studentëve që përfitojnë bursë, për vitin akademik 2022-2023 sipas kriterit ekonomik, shtesë në fazën e parë”, në mbledhjen e datës 02.05.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e 3 (tre) studentëve, që përfitojnë bursë sipas kriterit ekonomik, shtesë në fazën I, për vitin akademik 2022-2023, të cilët studiojnë në një program studimi të ciklit të parë dhe në një program studimi të integruar, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efekti financiar total është 270,000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë dhe përballohet nga buxheti i shtetit si pjesë e grantit të mësimdhënies së vitit 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETAR  
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI